

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“TB-SERVICE COMPANY” shpk

Ne Durres, sot me date, 08/09/2022 (dymije e njezet e dy), me cilësinë e “Ortakut themelues” **Z. Artan Boriçi** madhor, dhe me zotesi juridike dhe per te vepruar.

I cili me cilesine e “Ortakut themelues” kerkuan redaktimin e ketij Akti Themelimi, nepermjet te cilit deklarom se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe me iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregaret dhe shoqerite tregtare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, **“TB-SERVICE COMPANY” shpk**

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “TB-SERVICE COMPANY” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **“TB-SERVICE COMPANY” shpk**, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaku **Z. Artan Boriçi** i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojn personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e rregjistruar te Shoqerise.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka selin në : **Rruga e Kavajes, Square21, kati 7 godina Faza 3, Ap 1.7.4 Tirane**, Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Assamblese se ortakeve.



Neni 4
Objekti i veprimtarise

Përpunimi i të dhënave të kompanive, aktiviteti i " data entry ", menaxhimi i "pagave", menaxhimi i shërbimeve të kontabilitetit dhe telematike të përgjithshme, Konsulencë tregtare, administrative dhe tatimore me përjashtimin e aktiviteteve profesionale.

- Përpunimi i të dhënave, mbajtja e kontabilitetit, të përgjithshme dhe analitik për llogari të tregtare (profesioniste, ndërmarrje dhe private);
 - përgatitja, kontrolli dhe transmetimi i çdo lloje modeli, komunikimit, instance ose deklaratës së tatimit dhe tjera për ente private dhe publik
 - Zbatimi, analiza e planeve të kontrollit dhe menaxhimit, buxhetit, me kontrollin dhe përgatitjen e planeve të përmirësimit dhe efikasitetit, marrëdhëniet me furnizuesit dhe klientët e kompanive italiane dhe të huaja;
 - Konsulencë për bizneset, institucionet publike dhe private, italiane dhe të huaja, në çështje financiare, strategjia, industrial
 - Asistencë në operacionet e riorganizimit të korporatave dhe riorganizimit, shërbimet konsulencë të lidhura me aliancën, joint ventures, bashkim, shkrirje dhe kuotim, blerjet e kompanive, pjesëmarrje sociale, të kompanitë ose degë të tyre, ose operacionet tjera financiare shtesë
 - Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për kompanitë, institucionet publike ose private, Brenda ose jashtë shtetit për përgatitjen e studimeve dhe analizave të tregut, përgatitjen e planeve industriale, hulumtimi për partner strategjik
 - Organizimi i konferencave dhe eventeve
 - Organizimi, konsulentë administrativë shoqërorë në lidhje me detyrimet, konsulentë dhe mbajtje e të dhënave të lidhura me menaxhimit të personelit dhe saj dhe detyrimet përkatëse. Kompania mund të prezantojë çdo lloje praktikë ose instance në rrugë telematike ose të shkruar për çdo ente publike ose private. Shoqëria mund të regjistrojë kontrata qeraje, përdorimi, rinovimi; mund të paraqitja dhe dorëzojë dhe çdo lloje praktikë ose instancë në dhomën e tregtisë, suap, inail, inps, sian, sister dhe Agjencia e të ardhurave. Aktiviteti më sipas shëruar rruge ofrohen profesionistëve, shoqërorë dhe private italiane ose të huaja.
Shoqëria, për arritjen e objektit social, mund të ndërmarre të gjitha operacionet e nevojshme të tilla si operacionet tregtare, bankare, industriale, imobiliare dhe financiar
- Kompania mund të krijojë ose të marrë përsipër përfaqësime, koncesionet dhe filiale ose degë si brenda dhe jashtë vendit.



Neni 5
Kohezgjitja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit

KREU II - Kapitali

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestarë i shoqërisë është 100 000 (njqindë mijë) lekë,
Pjesëmarrja themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Ortaku themelues **Z. Artan Boriçi** : zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 leke, që përbënë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar është i nënshkruar plotësisht nga ortaku themelues në masën 100%
Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme .
Kontributi I ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të lujtshme/të palujtshme apo të drejta)
Ortakët përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundëjt të tretëve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë ;

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723,



date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III - ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Assambleja e ortakëve është organi vendimmarres i shoqërisë. Assambleja e ortakëve është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Assambleja e ortakëve vendos për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

Të gjitha vendimet e marra nga Assambleja e ortakëve regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhenat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e përgjithshme të regjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmerinë e tretit, që ka fituar të drejtë në mirebesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqërisë "TB-SERVICE COMPANY" shpk, caktohet, ortak i themeluar Z. Artan Borigi, e cila emerohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblejës së ortakëve të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Perfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabilistik të shoqërisë;
- d) Përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumenta përpara asambleës së përgjithshme për miratim;
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raporto përpara asambleës së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e asambleës në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktiviteti i Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administratorët, si së bashku edhe veçmas njëri tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorët e perfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo të huaja, autoritetëve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të Shoqërisë.



Administratoret angazhojn Shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk mer persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e Shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar I Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti I pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor

Neni 12

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakeve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimi
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te Gjykates

Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper"

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise

Neni 14

Dispozita perfundimtare



Ky akt themelimi u redaktua ne 4 (kater) ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti I mesiper m pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Z. Artan Boriçi

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized, cursive script that reads "Artan Boriçi". The signature is written in a fluid, connected style.